

Vendim nr. 248, datë 17.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Marjana Semini,	Anëtare
Asim Vokshi,	Anëtar

në datën 17.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (L) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LULZIM HAMITAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1603 (60-2014-2474), datë 11.11.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2025-3581, datë 16.10.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Pezullimi i vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 2069, datë 23.09.2013, i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është trashëgimtar ligjor i të atit të tij të ndjerë, i cili ka qenë palë e paditur në një proces gjyqësor civil. Konkretisht, mosmarrëveshja ka konsistuar në faktin se disa shtetas të trajtuar me tokë bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, tashmë i shfuqizuar (*Ligji për Tokën*), kanë pretenduar se të paditurit, përfshirë trashëgimlënësin e kërkuesit, posedonin në mënyrë të paligjshme pronën e tyre, të fituar gjithashtu nëpërmjet ligjit për tokën. Në këto kushte, ata i janë drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e të paditurve që të lironin e dorëzonin parcelën bujqësore me numër kadastral 350/1, të llojit “arë”, të ndodhur në Dukat të Ri.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2069, datë 23.09.2013, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e të paditurve të lirojnë e t’u dorëzojnë paditësve sipërfaqen 6302 m², e cila ka rezultuar të jetë zënë sipas skicës nr. 3 të aktit të ekspertimit topografik të administruar në gjykim. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim të paditurit S.V. (E.H.), J.H. dhe S.H.

3. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1603 (60-2014-2474), datë 11.11.2014. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs të paditurit S.V. (E.H.), J.H. dhe S.H.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-3581, datë 16.10.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi ka vlerësuar se është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), me arsyetimin se nuk rezulton që në gjykim të jenë lejuar shkelje procedurale që do të bënin të pavlefshëm procesin dhe do të ndikonin në vendimmarrjen e gjykatave. Gjithashtu, ajo gjykatë ka konstatuar se gjykatat e faktit e kanë respektuar ligjin material, duke e interpretuar dhe zbatuar drejt atë, dhe se vendimet e dhëna prej tyre nuk janë në kundërshtim me ndonjë vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Nga ana tjetër, ajo gjykatë ka sjellë në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë dhe se nëpërmjet rekursit nuk mund të pretendohet të rihapet edhe një herë shqyrtimi gjyqësor i provave.

5. Në datën 22.04.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave ligjore, është regjistruar më 30.04.2026.

II

Pretendimet e kërkuessit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar:

6.1.*E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, për shkak të mosnjohimit të akteve të çështjes, të ankimit dhe rekursit, si dhe të vendimeve përkatëse nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë, duke i hequr të drejtën kërkuessit të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij, ndërsa ai është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm pas bërjes publike të tij. Nuk rezulton që të jenë respektuar nenet 128-133/b të KPC-së, për sa i përket njoftimit të kërkuessit për aktet e dosjes, për vendimet (vendime të ndërmjetme dhe përfundimtare), për ankimet përkatëse (apel dhe rekurs), si dhe për datat e seancave gjyqësore (kjo vlen për të tria shkallët e gjyqësorit). Në këtë mënyrë, kërkuessi është vënë në pamundësi objektive jo vetëm për të marrë dijeni për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor, por edhe për të ushtruar të drejtat e tij që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, pra për të paraqitur, përmes ankimit (të cilitdo lloji) ose parashtrimeve në proces, pretendime në mbrojtje të interesave të tij ligjorë e kushtetues. Edhe pse gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë detyrimin të verifikojnë nëse administrata gjyqësore e gjykatës së shkallës së parë ka marrë masat për të kryer njoftimin e ankimit dhe/ose rekursit palëve ndërgjyqëse, ato nuk janë ndalur në kryerjen e këtij vlerësimi. Pasojat e shkeljeve në lidhje me njoftimin e vendimeve, të ankimit dhe rekursit, kanë ndikuar në të drejtën e aksesit të kërkuessit, për rrjedhojë edhe në të drejtën për t'u dëgjuar në atë gjykatë, në respektim të parimit të barazisë së armëve.

6.2.*E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi kërkuessi detyrohet që të dorëzojë te paditësit në procesin gjyqësor civil një send të fituar në mënyrë të ligjshme përmes trashëgimisë nga babai i tij, i cili e kishte përfituar në zbatim të reformës agrare sipas Ligjit për Tokën, pa qenë pjesëmarrës në procesin e nisur ndaj tij, ku gabimisht është trajtuar sikur të ishte një uzurpues i paligjshëm.

6.3.*Parimet e sigurisë juridike dhe ligjshmërisë*, që burojnë nga neni 4 i Kushtetutës, pasi vendimet e kundërshtuara e kanë zhveshur kërkuessin nga një e pronë e fituar në mënyrë të ligjshme përmes proceseve qartësisht të parregullta ligjore, gjatë të cilave

kërkuesi nuk është njoftuar për zhvillimin e gjykimit dhe për vendimet përkatëse, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar shkaqet thelbësore të rekursit të të paditurve.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi trashëgimlënësi i tij ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar dhe gjykata e shkallës së parë ka bërë kalimin procedural tek trashëgimtarët (përfshirë kërkuesin) pasi ai ka ndërruar jetë, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 16.10.2025 dhe është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 24.12.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 22.04.2026, pra brenda afatit 4-mujor.

9. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur e për t’u dëgjuar, si dhe me parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, duke

argumentuar se nuk është njoftuar për aktet e dosjes, si dhe për vendimet e ankimet përkatëse, duke u vënë në pamundësi objektive për të marrë dijeni për vënien në lëvizje të procesit gjyqësor, por edhe për të ushtruar të drejtën për të paraqitur, përmes ankimit ose parashtrimeve në proces, pretendime në mbrojtje të interesave të tij ligjorë e kushtetues. Sipas tij, kjo shkelje ka sjellë pasoja në të drejtën për pronë private, duke cenuar edhe parimet e sigurisë juridike dhe të ligjshmërisë. Nisur nga thelbi i pretendimeve, Kolegji çmon që ato të analizohen në drejtim të së drejtës së aksesit substancial lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur.

B. Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur

10. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë mohuar të drejtën për të paraqitur ankime dhe parashtrime, për shkak të moskomunikimit të akteve të dosjes, vendimeve dhe ankimeve përkatëse, duke i mohuar të drejtën atij të ndjekë vijueshmërinë e çështjes së tij, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë vetëm pas publikimit të saj në faqen zyrtare.

11. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje Gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën

kundërshtare (*shih vendimet nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. E drejta e palës për t'u njoftuar për argumentet e faktet e parashtruara në ankimin e palës tjetër është pjesë e së drejtës së individit për proces të rregullt, nëpërmjet së cilës atij i krijohet mundësia të përgatisë mbrojtjen e vet e të parashtrojë argumentet ndaj pretendimeve të palës tjetër (*shih vendimet nr. 18, datë 04.04.2023; nr. 5, datë 26.01.2007; nr. 15, datë 13.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit, pavarësisht nëse i shqyrton çështjet në seancë të hapur publike ose mbi bazë të dokumenteve, ka detyrimin të verifikojë nëse palët në proces kanë marrë dijeni efektivisht për rekursin dhe procesin, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të parimit të barazisë së armëve në gjykim. Vetëm njoftimi me shpallje nuk nënkupton përmbushjen e detyrimit të sekretarisë së Gjykatës së Lartë për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjohen e të mbrohen me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve (*shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2023; nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 21, datë 04.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas dispozitave të KPC-së që parashikojnë rregulla për njoftimet e individëve, thirrja në gjykatë bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjes (*neni 129, paragrafi 1*). Njoftimi shkresor bëhet nëpërmjet dorëzimit nga punonjësi i gjykatës ose shërbimi postar i letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të thirrur, kudo ku ai gjendet (*neni 130, paragrafi 1*). Kur nuk është i mundur njoftimi sipas kësaj dispozite, njoftimi bëhet në vendbanimin ose vendqëndrimin e personit të thirrur (*neni 131, paragrafi 1*). Në qoftë se personi i thirrur nuk gjendet në një nga këto vende, njoftimi i dorëzohet një personi të familjes që ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, dhe kur nuk ndodhet ndonjë prej tyre, njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet fqinjëve, që pranojnë t'ia dorëzojnë atë personit të thirrur, zyrës ose qendrës së punës së tij, përveçse kur marrësi është i mitur, nën gjashtëmbëdhjetë vjeç ose është i pazoti për të vepruar (*neni 131, paragrafi 2*). Kur nuk është e mundur të bëhet njoftimi, sipas paragrafit të mësipërm, kopja e njoftimit i dorëzohet portierit të ndërtesës së banimit, të zyrës ose të qendrës së punës (*neni 131, paragrafi 3*). Në të gjitha këto raste, personi që merr njoftimin, duhet të nënshkruajë origjinalin ose kopjen e saj, duke marrë përsipër detyrimin që kopjen tjetër t'ia dorëzojë personit të thirrur (*neni 131, paragrafi 4*). Kur anëtarët e familjes së personit që i drejtohet njoftimi ose fqinjët të cilëve u jepet njoftimi për t'ia dorëzuar personit të cilit i drejtohet njoftimi, nuk pranojnë të marrin në dorëzim njoftimin, nuk dinë ose nuk mund të nënshkruajnë, bëhet shënimi në kopjen e njoftimit dhe, kur është e mundur, vërtetohet edhe me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer

(neni 132). Kushdo mund të emërojë një person të autorizuar për marrjen e njoftimeve. Akti i emërimit depozitohet në gjykatë (neni 133, pika 1). Njoftimi bëhet me shpallje publike nëse: a) nuk është e mundur të realizohet njoftimi sipas parashikimeve të neneve 129, 130, 131, 132 dhe 133 dhe pasi punonjësi i gjykatës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e adresës së personit që i drejtohet njoftimi; ose b) personi, të cilit i drejtohet njoftimi nuk ka vendbanim, vendqëndrim, nuk ka zgjedhur një banesë ose nuk ka caktuar një përfaqësues në Republikën e Shqipërisë dhe nuk ka qenë i mundur njoftimi i tij sipas njërës nga mënyrat e parashikuara nga ligji (neni 133/a). Njoftimi me shpallje publike kryhet me anë të afishimit të tij në gjykatën e vendit ku do të gjykohet mosmarrëveshja, në vendin ku personi të cilit i drejtohet njoftimi ka vendbanimin ose në vendqëndrimin e tij, si edhe në njësinë administrative në të cilën ka vendbanimin ose vendqëndrimin (neni 133/b, pika 1). Ky njoftim qëndron i afishuar për jo më pak se 20 ditë (neni 133/b, pika 5).

16. Në dritën e dispozitave të ligjit të zbatueshëm si më sipër dhe referuar akteve të dosjes gjyqësore të administruar për qëllim të shqyrtimit paraprak të kësaj kërkesë, Kolegji vëren se me fletëthirrjen e datës 22.05.2012 Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë ka njoftuar trashëgimlënësin e kërkuarit që të paraqitej në datën 04.06.2012 për t'u dëgjuar si palë e paditur në gjykim. Pasi ka marrë dijeni se pala e paditur Hamit Hamiti kishte ndërruar jetë, në seancën përgatitore të datës 27.09.2012 ajo gjykatë ka administruar dëshminë e trashëgimisë së tij dhe ka vijuar me kalimin procedural për të thirrur në gjykim trashëgimtarët, përfshirë kërkuarin.

17. Në seancën përgatitore të datës 10.10.2012 avokati i palës paditëse ka depozituar shkresën nr. 3480/1, datë 08.10.2012 të Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin Vlorë, lënda "Kthim përgjigje", nga ka rezultuar se kërkuari ishte jashtë shtetit që prej datës 31.08.2012 dhe ka kërkuar kohë për plotësimin e adresës së tij. Në seancën e datës 24.10.2012 avokati i palës paditëse ka paraqitur vërtetimin e datës 22.10.2012 të lëshuar nga Bashkia e Vlorës, rajoni numër 3, në lidhje me disa adresa, përfshirë atë të kërkuarit. Gjykata e rrethit gjyqësor ka vendosur të shtyjë seancën me qëllim njoftimin, ndër të tjerë, të kërkuarit në adresën e saktësuar. Në seancën përgatitore të datës 06.11.2012, gjykata e rrethit gjyqësor, pasi ka konstatuar se fletëthirrja nr. 2531 akti, datë 29.10.2012 drejtuar kërkuarit ishte kthyer me shënimin "Larguar", ka vendosur se në kushtet kur provohej vendbanimi i tij, bazuar në nenet 125, 175 dhe 131 të KPC-së, të procedojë me njoftimin me shpallje për kërkuarin. Avokati i paditësve dhe avokati i nënës së kërkuarit kanë deklaruar se ishin dakord. Me shpalljen publike nr. 2531 akti, datë 06.11.2012, të afishuar në ambientet e Zyrës së Gjendjes Civile, Rajoni nr. 3, Vlorë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ajo gjykatë ka njoftuar kërkuarin për t'u paraqitur në seancën gjyqësore të datës 26.11.2012

(e cila nuk është zhvilluar). Në seancën përgatitore të datës 19.12.2012 avokati i paditësve ka kërkuar të përsëritet njoftimi me shpallje, duke qenë se të paditurit, përfshirë kërkuesin, janë larguar jashtë shtetit. Avokati i nënës së kërkuesit ka deklaruar se ishte dakord. Njoftimi me shpallje është përsëritur brenda së njëjtës ditë. Në seancën përgatitore të datës 14.01.2013 gjykata ka konstatuar se njoftimet me anë të shpalljes ishin kryer, ndërsa avokati i paditësve ka deklaruar se ishte dakord që gjykimi të vazhdonte në mungesë, ndër të tjerë, të kërkuesit. Me ndryshimin e gjyqtarit relator të çështjes, gjykata e rrethit gjyqësor i ka dërguar sërish fletëthirrje kërkuesit në adresën e përcaktuar në vërtetimin e Bashkisë së Vlorës. Në seancat e datave 18.02.2013 dhe 05.03.2013, ajo gjykatë ka evidentuar se fletëthirrja drejtuar kërkuesit nuk rezultonte të ishte kthyer dhe ka vendosur të përsëritet njoftimi. Më pas, ajo gjykatë ka vijuar me njoftimet nëpërmjet shpalljeve publike për zhvillimin e seancave gjyqësore të datave 20.03.2013, 03.04.2013, 30.04.2013 dhe 16.05.2013, të cilat janë afishuar pranë asaj gjykate dhe pranë vendbanimit të kërkuesit. Në diskutimet përfundimtare të datës 19.09.2013, avokati i të paditurve ka paraqitur konkluzionet edhe për llogari të kërkuesit.

18. Çështja është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila në seancën e datës 11.11.2014 ka konstatuar se pala e paditur (ndër ta edhe kërkuesi) nuk ishte paraqitur ndonëse kishte marrë dijeni me shpallje, ndaj ka vendosur që gjykimi të zhvillohej në mungesë të tyre. Kopje e vendimit të kësaj gjykate për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, i është dërguar kërkuesit në adresën e fundit të deklaruar, nëpërmjet dëftesës së komunikimit nr. 2766/1875 akti, datë 12.01.2015, e cila është nënshkruar nga i padituri tjetër S.V. (E.H.).

19. Kundër këtij vendimi të mësipërm kanë paraqitur rekurs tre prej të paditurve. Kopja e rekursit i është njoftuar edhe kërkuesit, gjithashtu i paditur, në adresën e deklaruar në dosjen gjyqësore nëpërmjet dëftesës së komunikimit nr. 2531 akti, datë 02.06.2015, e cila është kthyer mbrapsht me shënimin “Larguar”. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka dërguar pranë saj dhe pranë Rajonit nr. 3 të Bashkisë së Vlorës shpalljen publike nr. 2351 akti, datë 01.09.2015 drejtuar kërkuesit për efekt të komunikimit të rekursit.

20. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar të kryer njoftimin për kërkuesin, pasi punonjësi i gjykatës dhe pala paditëse kanë marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e adresës së kërkuesit, duke përfshirë njoftimin nëpërmjet fletëthirrjes në adresën e deklaruar nga ai në zyrat e gjendjes civile (vërtetimi i datës 22.10.2012 lëshuar nga Bashkia e Vlorës, Rajoni Numër 3) dhe pasi ka konstatuar se ai ndodhej jashtë shtetit, ka proceduar me njoftimin nëpërmjet shpalljes publike përpara çdo seance. Shpallja është afishuar në gjykatën që po shqyrtonte çështjen, në zyrën e gjendjes civile përkatëse, si dhe në vendbanimin e fundit të

deklaruar nga kërkuesi. Po ashtu, edhe gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim çështjen në mungesë të kërkuesit, pasi e ka njoftuar atë nëpërmjet shpalljes. Edhe rekursi i depozituar në Gjykatën e Lartë nga të paditurit e tjerë i është njoftuar kërkuesit fillimisht nëpërmjet fletëthirrjes (nr. 2531 akti, datë 02.06.2015) dhe me pas nëpërmjet shpalljes publike në ambientet e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe pranë Rajonit nr. 3 të Bashkisë së Vlorës (shpallja publike nr. 2351 akti, datë 01.09.2015). Në këtë kuptim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm që kanë shqyrtuar çështjen në të cilën kërkuesi ishte në cilësinë e palës së paditur, nuk duket të kenë vepruar në mosrespektim të ligjit procedural për sa i përket njoftimit të palëve, përkundrazi ato kanë vepruar në përputhje me të, duke garantuar për kërkuesin të drejtën për proces të rregullt ligjor, përfshirë edhe njoftimin e rregullt si element të këtij procesi.

21. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial të lidhur me të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar, ndaj edhe pretendimet e ndërlidhura janë haptazi të pabazuara. Rrjedhimisht, nuk mund të merret në shqyrtim as kërkimi për pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, pasi bazuar në nenin 45 të Ligjit Organik të Gjykatës, pezullimi vendoset në rast se vlerësohet se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

22. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.